

PHILIPS

AVENT

SCF355



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

E rëndësishme	3
Fushat elektromagnetike (EMF)	5
Hyrje.....	6
Përdorimi i ngrohëses së shishes	6
Përmbledhje e produktit	6
Shpjegimi i cilësimeve	7
Përdorimi i ngrohëses së shishes me cilësimin e ngrohjes ekspres të qumështit	8
Tabela referencë e ngrohjes ekspres	10
Përdorimi i ngrohëses së shishes për të ngrohur ushqim për foshnja	11
Përdorimi i cilësimit Keep Warm për ngrohjen e qumështit	12
Përdorimi i ngrohëses së shishes me cilësimin e shkrirjes	13
Pastrimi dhe deskorjezimi	15
Pastrimi	15
Deskorjezimi	16
Riciklimi.....	17
Mbështetja	17
Zgjidhja e problemeve	17

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta përdorni ngrohësen e shishes dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhysni kordonin, spinën apo pajisjen në ujë apo në lëngje të tjera.

Paralajmërim

- Përdoreni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura.
- Mos e lini kordonin elektrik të varet nga skaji i tryezës apo syprina. Kordonin e tepërt mund ta ruani në bazamentin e ngrohësit të shishes.
- Mbajeni kordonin elektrik larg sipërfaqeve të nxehta.
- Pajisjen lidheni vetëm me priza të tokëzuara. Sigurohuni gjithnjë që spina të futet siç duhet në prizë.
- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pjesën e poshtme të pajisjes përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Nëse ju duhet të përdorni një kordon zgjatues, sigurohuni të jetë kordon i tokëzuar zgjatues me specifikim prej së paku 13 amperësh.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar. Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", nga një pikë servisi e autorizuar nga "Philips" ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangni rreziqet.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë furnelave të nxehta me gaz apo elektrike, apo në furrë të ndezur.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë me aftësi të reduktuara fizike, shqisore apo mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes, si dhe të kuptojnë rreziqet e përfshira.

- Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 3 vjeç e lart nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes, si dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët, përveç nëse janë më të mëdhenj se 8 vjeç dhe nën mbikëqyrje. Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët nën 3 vjeç.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Mos derdhni ujë mbi spinën elektrike.
- Përdoreni pajisjen vetëm sipas përshkrimit në manualin e përdorimit për të evituar lëndimet e mundshme për shkak të keqpërdorimit.
- Mos e parangrohni pajisjen.
- Vendoseni gjithnjë shishen të mbyllur me kapak në ngrohësen e vet përpara se t'i shtoni ujë.
- Sigurohuni të shtoni ujë përpara se ta ndizni ngrohësen e shishes.
- Uji i nxehtë mund të shkaktojë djegie të rënda. Bëni kujdes kur ngrohësja e shishes përmban ujë të nxehtë.
- Sipërfaqet e arritshme të pajisjes mund të nxehen gjatë përdorimit dhe mund të mbesin të tilla pas përdorimit.
- Mos e hiqni pajisjen kur përmban ujë të nxehtë.
- Kur ushqimi apo qumështi ka arritur temperaturën e kërkuar, hiqeni shishen ose enën nga ngrohësja e shishes. Nëse e lini ushqimin apo qumështin në ngrohësen e shishes, temperatura e ushqimit apo e qumështit do të rritet.
- Kontrollojeni gjithnjë temperaturën e ushqimit përpara se të ushqeni fëmijën. Përziejeni me të lehtë shishen dhe kontrollojeni duke hedhur ca pika nga ana e brendshme e kështjës së dorës.

Kujdes

- Pajisja është menduar për përdorim familjar dhe përdorime të ngjashme, si p.sh. në shtëpitë në fshat, në ambiente të llojit bujtina, në ambientet e kuzhinës së stafit në dyqane, në zyra dhe ambiente të tjera pune, si dhe nga klientët në hotele, motele dhe ambiente të tjera banimi.
- Hiqeni pajisjen nga priza kur nuk e përdorni.
- Sipërfaqja e rezistencës mund të ketë nxehtësi të mbetur edhe pas përdorimit.
- Lëreni pajisjen të ftohet përpara se ta pastroni.
- Ndiqni udhëzimet e deskoriezimit për të evituar dëme të pariparueshme.
- Mos u përpiqni ta hapni apo riparoni vetë pajisjen. Mund të kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit të "Philips" për shtetin tuaj (shihni **www.philips.com/support**).
- Ushqimi nuk duhet ngrohur për shumë kohë.

Data e kodit të prodhimit YYWW ndodhet në folenë e mbajtjes së kordonit në bazamentin e ngrohëses së shishes.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje "Philips" pajtohet me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Hyrje


Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë Philips Avent! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips Avent", regjistroni produktin në faqen **www.philips.com/welcome**.

Me këtë ngrohës shishesh mund të ngrohni në mënyrë të sigurt të gjitha shishet "Philips Avent" dhe qumështin/ushqimin për foshnja në enë dhe në kavanoza të tjerë me ushqim për foshnja.

Shënim: Qeskat e qumështi të gjirit "Philips Avent" dhe shishet "Philips Avent" 60 ml nuk mund të përdoren në këtë ngrohëse shishesh.

Përdorimi i ngrohëses së shishes

Përmbledhje e produktit




Shpjegimi i cilësimeve


	Ngrohësja e shishes fiket dhe drita është e fikur. Në çdo cilësim tjetër pajisja ndizet dhe drita është e ndezur.
	Zgjidhni këtë cilësim kur dëshironi të ngrohni shpejt një shishe qumështi në temperaturë ambiente (22°C) me përmbajtje nga 60 ml deri në 330 ml ose në temperaturë të ftohtë (5°C) me një përmbajtje nga 60 ml deri në 240 ml. Shishja duhet të nxirret menjëherë pas ngrohjes në temperaturën e duhur, përndryshe qumështi do të nxehet.
	Zgjidhni këtë cilësim kur doni të ngrohni shpejt një shishe qumështi në temperaturë të ftohtë (5°C) me përmbajtje nga 270 ml deri në 330 ml. Shishja duhet të nxirret menjëherë pas ngrohjes në temperaturën e duhur, përndryshe qumështi do të nxehet.
	Zgjidhni këtë cilësim kur doni të ngrohni një enë/kavanoz ushqimi për foshnja.
	Ky cilësim e ngroh qumështin në shpejtësi më të ulët dhe më pas e mban të ngrohtë.
	Shkrini një shishe/enë qumështi/usqimi për foshnja në gjendje të lëngët. Nuk kryhet ngrohja.

Përdorimi i ngrohëses së shishes me cilësimin e ngrohjes ekspres të qumështit

- 1** Vendosni spinën elektrike në prizë. Vendosni një shishe në ngrohësen e shishes.



- 2** Mbushni ngrohësen e shishes me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit në shishe. Në rast se keni sasi të mëdha qumështi, niveli maksimal i ujit duhet të jetë rreth 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes. Niveli i saktë i ujit garanton performancën e duhur të ngrohjes.




- 3** Zgjidhni cilësimin e dëshiruar në bazë të vëllimit të qumështit. Shihni tabelën referencë të ngrohjes ekspres në fund të këtij kapitulli për të parë se për sa kohë duhet ngrohur qumështi sipas cilësimit të përzgjedhur.



Shënim

- Shpejtësia e ngrohjes së qumështit varet nga sasia e qumështit të ngrohur dhe nga temperatura e tij fillestare, d.m.th. në temperaturë ambienti (22°C) ose në temperaturë frigoriferi (5°C).



- 4** Drita portokalli ndizet kur zgjidhni një cilësim. Kjo tregon se ngrohësja e shishes është ndezur.



Shënim

- Gjatë ngrohjes, qumështi qarkullon dhe ngrohet njëtrajtësisht.

- 5** Kontrolloni tabelën referencë të ngrohjes ekspres për të parë kohën e nevojshme për ngrohjen e qumështit. Pas kalimit të kohës të indikuar në tabelën referencë të ngrohjes ekspres, hiqeni shishen për ushqim ose kthejeni çelësin në “Keep Warm” për ta mbajtur qumështin të ngrohtë në temperaturën e duhur.




Këshillë

- Kur vini re se qumështi nuk është ngrohur mjaftueshëm, mund ta vendosni sërish shishen në pajisje për maksimumi 30 sekonda ngrohje të mëtejshme. Kjo do të krijojë një rezultat disi më të ngrohtë, por pa mbinxehje.


Kujdes

- Nëse e lini shishen në ngrohëse më gjatë se koha e përcaktuar në tabelën e cilësimeve, qumështi mund të mbinxehet.
- Nëse qumështi i gjirit mbinxehet, ai mund të humbasë vlera ushqyese dhe vitamina.

- 6** Kontrolloni gjithnjë temperaturën përpara se të ushqeni fëmijën. Tundeni lehtë shishes ose enën e mbajtjes së qumështit dhe kontrolloni temperaturën e qumështit duke spërkatur disa pika nga ana e brendshme e kyçit.



- 7** Kthejeni çelësin sërish në pozicionin fikur.



! Kujdes

- Uji në ngrohësen e shishes mund të jetë i nxehtë pasi të ketë përfunduar ngrohja e qumështit/ ushqimit për foshnja. Kini kujdes pasi uji i nxehtë mund të shkaktojë djegie të rënda.
- Nëse nuk e ktheni çelësin në pozicionin "fikur", uji do të vazhdojë të ngrohet dhe do të arrijë një temperaturë shumë të lartë.

Tabela referencë e ngrohjes ekspres


ml			
	22°C	5°C	5°C
60 - <150 ml	2 - 3 min.	5 - 6 min.	-
150 - <210 ml	3 - 4 min.	6 - 7 min.	-
210 - <270 ml	4 - 5 min.	7 - 9 min.	-
270 - 330 ml	5 - 6 min.	-	8 - 10 min.

Shënim

- Kohët e treguara të ngrohjes bazohen në shishet e polipropilenit "Philips Avent Natural" dhe "Anti-colic". Kini parasysh se kohët e ngrohjes të "Philips Avent Anti-colic" me shishet e polipropilenit me valvulë "AirFree" dhe shishet e qelqit "Natural" devijojnë nga këto indikacione. Përveç llojit dhe materialit të shishes, karakteristikat si trashësia mund të ndikojnë gjithashtu negativisht në kohën e ngrohjes. Ndaj mund dhe të marrë më pak kohë ngrohja e një sasi më të madhe qumështi.
- Qumështi mund t'ju duket i ftohtë, por temperatura e tij është mjaft e kënaqshme për një foshnjë të sapolindur.

Përdorimi i ngrohëses së shishes për të ngrohur ushqim për foshnja

- 1** Ndiqni të njëjtat hapa siç tregohet në kapitullin e mëparshëm.
- 2** Sigurohuni ta trazoni ushqimin për foshnja gjatë ngrohjes, pasi ky nuk qarkullon automatikisht. Bëni kujdes të mos digjini gishtat kur e mbani enën/kavanozin gjatë trazimit.





Pas ngrohjes, provoni me lugë ushqimin për foshnjën për t'u siguruar që nuk është shumë i nxehtë. Nëse ushqimi për foshnjën nuk është mjaftueshëm i ngrohtë, vendosni sërish enën në ngrohësen e shishes dhe ngrohni ushqimin e foshnjës derisa të arrijë temperaturën e dëshiruar.

Shënim



- Për shkak të larmisë së konsistencave të ushqimeve, rekomandohet fuqimisht që ta trazoni vazhdimisht dhe ta kontrolloni ushqimin e foshnjës gjatë ngrohjes, për një rezultat optimal.
- Për shkak të larmisë së konsistencave të ushqimeve për foshnja, nuk është e mundur që të tregohet koha e ngrohjes për to.

Përdorimi i cilësimit Keep Warm për ngrohjen e qumështit


- 1** Vendosni spinën elektrike në prizë. Vendosni shishen ose enën në ngrohësen e shishes.



- 2** Mbushni ngrohësen e shishes me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit në shishe/enë. Në rast se keni sasi të mëdha qumështi, niveli maksimal i ujit duhet të jetë rreth 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.




- 3** Zgjidhni pozicionin e mbajtjes ngrohtë.



Në këtë cilësim mund ta ngrohni qumështin më ngadalë dhe ta mbani të ngrohtë në temperaturën e duhur fundore. P.sh. për të ngrohur një shishe qumështi 120 ml duke filluar nga temperatura e ambientit, do të duhen 15-20 minuta. Koha e ngrohjes mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër në varësi të sasisë së qumështit dhe temperaturës fillestare.



- "Philips Avent" rekomandon ta ushqeni foshnjën sa më shpejt të jetë e mundur pas ngrohjes së qumështit. Ju rekomandojmë të mos e ringrohni qumështin pasi të jetë ftohur sërish.
- Kontrolloni gjithnjë temperaturën përpara se të ushqeni fëmijën.

4 Ktheni çelësin në pozicionin "fikur" pasi shishja/ena të hiqet nga ngrohësja e shishes.





Përdorimi i ngrohësës së shishes me cilësimin e shkrirjes

1 Futni spinën e pajisjes në prizën në mur. Vendosni shishen ose enën në ngrohësen e shishes.




2 Mbushni ngrohësen e shishes me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit/ ushqimit për foshnja në shishe/enë. Në rast se keni sasi të mëdha qumështi/ ushqimi për foshnja, niveli maksimal i ujit duhet të jetë rreth 1 cm poshtë majës së ngrohësës së shishes.





3 Zgjidhni pozicionin e shkrirjes.



Në këtë cilësim qumështi/ushqimi për foshnja mund të shkrihet në gjendje të lëngët. Për qumështin e ngrirë, kontrolloni tabelën referencë të ngrohjes për të parë kohën e parashikuar të shkrirjes. Pas shkrirjes së qumështit, zgjidhni cilësimin e ngrohjes ekspres ose të mbajtjes ngrohtë për ta ngrohur qumështin. Shihni kapitujt e mëparshëm për udhëzimet e përdorimit. Kini parasysh temperaturën fillestare të qumështit rreth temperaturës së frigoriferit për kohët e ngrohjes si tregues i përafërt.

	ml	orë
	60 -90 ml	1-1,5
	120 -150 ml	1,5-2
	180 -210 ml	1,5-2,5

4 Ushqimin për foshnja mund ta shkri në gjithashtu në enën e ushqimit "Philips Avent" me anë të këtij cilësimi. Pas shkrirjes së ushqimit për foshnja, zgjidhni cilësimin e ngrohjes së ushqimit për ta ngrohur atë. Shihni kapitullin e mëparshëm për udhëzimet e përdorimit.

Shënim

- Për shkak të larmisë së konsistencave të ushqimeve, rekomandohet fuqimisht që ta trazoni vazhdimisht dhe ta kontrolloni ushqimin e foshnjës gjatë ngrohjes, për një rezultat optimal.
- Për shkak të larmisë së konsistencave të ushqimeve për foshnja, nuk është e mundur që të tregohet koha e ngrohjes për to.


Pastrimi dhe deskorjezimi

Pastrimi

- 1 Pas çdo përdorimi, hiqeni ngrohësen e shishes nga priza dhe lëreni të ftohet.
- 2 Hiqeni ujin nga ngrohësja e shishes për arsye higjienike.



- 3 Fshini pjesën e jashtme dhe të brendshme të ngrohësës së shishes me një leckë të njomë.
↳ Mos përdorni abrazivë, solucione antibakteriale pastrimi, solucione kimike apo mjete të mprehta për pastrimin e ngrohësës së shishes.



Shënim

- Nëse e keni përdorur ngrohësen e shishes për ngrohjen e ushqimit për foshnja, sigurohuni që në fund të ngrohësës të mos mbetet ushqim i derdhur.

Deskorjezimi

Rekomandohet ta deskorjezoni ngrohësen **çdo katër javë** për t'u siguruar që punon me efikasitet.

- 1 Përzieni 50 ml uthull të bardhë me 100 ml ujë të ftohtë për të deskorjezuar ngrohësen e shishes. Ndizeni ngrohësen e shishes, zgjidhni cilësimin 1 të

ngrohjes ekspres të qumështit dhe lëreni pajisjen të punojë për 10 minuta. Lëreni solucionin në ngrohësen e shishes derisa të shpërbëhet e gjithë skoria.




Shënim

- Mund dhe të përdorni deskorjezues me bazë acidi citrik.
- Mos përdorni lloje të tjera zhgëlqerëzuesish.

2 Hiqni nga priza ngrohësen e shishes përpara se ta zbrazeni atë.



3 Zbrazeni ngrohësen e shishes dhe shpëlajeni mirë nga brenda. Nëse shihni ende gjurmë çmërsi pas shpëlarjes, përsëriteni procedurën e pastrimit të tij.



Riciklimi

Ky simbol do të thotë që produktet elektrike nuk duhet të hidhen me mbeturinat e zakonshme të shtëpisë.

Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike.



Mbështetja

Për mbështetje për të gjitha produktet, si pyetjet më të shpeshta, vizitoni www.philips.com/support.



Shënim

- Konsumi i energjisë (modaliteti i fikur): <0,3 W (kohë deri në modalitetin automatik të fikjes: <1min)

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin tuaj.

Problemi	Zgjidhja
Qumështi është shumë i nxehtë.	Mund të keni zgjedhur një cilësim të pasaktë ose ta keni lënë shishen në ngrohëse më shumë se koha e përcaktuar në tabelën e cilësimeve. Zgjidhni cilësimin dhe kontrolloni kohën e kërkuar për të ngrohur qumështin sipas "Tabelës referencë të ngrohjes ekspres". Pas kalimit të kohës së indicuar në tabelën referencë të ngrohjes ekspres, nxirreni menjëherë shishen ose kthejeni çelësin në "Keep Warm" përta mbajtur qumështin të ngrohtë, përndryshe qumështi do të mbinxehet.
Qumështi është ende i ftohtë.	Mund të keni zgjedhur një cilësim të gabuar ose po përdorni shishe silikoni. Zgjidhni cilësimin dhe kontrolloni kohën e kërkuar për të ngrohur qumështin sipas "Tabelës referencë të ngrohjes ekspres". Pas kalimit të kohës së indicuar në tabelën referencë të ngrohjes ekspres, nxirreni menjëherë shishen ose kthejeni çelësin në "Keep Warm" përta mbajtur qumështin të ngrohtë, përndryshe qumështi do të mbinxehet. Nëse po përdorni shishe silikoni, pas kalimit të kohës së indicuar në tabelën referencë të ngrohjes ekspres, prisni për 30-60 sekonda sa të ngrohet qumështi.
Ngrohësja e shishes e shkrin shumë ngadalë qumështin.	Qumështi nuk duhet të shkrihet kurrë në temperaturë të lartë pasi kjo sjell humbjen e vlerave ushqimore. Për shkak të temperaturës së butë me të cilën shkrihet qumështi, mund të duhet më shumë kohë se sa pritet për shkrirjen e qumështit.
Ngrohësja e shishes ndalon së punuari gjatë procesit të ngrohjes. Nuk mund ta ndez ngrohësen e shishes.	Fundi i ngrohëses së shishes mund të bllokohet nga skoria. Ngrohësja e shishes duhet të deskorjehet të paktën çdo katër javë. Shihni pjesën "Pastrimi i bigorrit".

